



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1057/prot.
1

Tiranë, më 31/5/2019

URDHËR

Nr. 320 datë 31/5/2019

PËR

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHËRIN NR. 46, DATË 29.01.2019 "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SHFRYTËZIMIT TË DOKUMENTEVE
ARKIVORE NË SALLËN E STUDIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
ARKIVAVE"**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b të ligjit Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", dhe të gërmës gj), të nenit 4, të kreut I, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, "Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren bashkëlidhur urdhërit nr. 46, datë 29.01.2019, bëhen këto ndryshime:
 - a. Pika 2 e nenit 1 ndryshon si më poshtë:
"2. Salla e studimit pranë DPA-së shërben me këtë orar: E martë-e premte: 09:00-19:00 dhe e shtunë 09:00-14:00. Dita e dielë dhe dita e hënë janë ditët e pushimit të sallës. Dokumentet në origjinal shërbehen deri në jo më vonë se 30 minuta nga orari i mbylljes së sallës."
 - b. Pas pikës 11 të nenit 7, shtohet pika 12, me këtë përmbajtje:
"8. Për porositë e ardhura nga sistemi "Arkiva Online", përgjegjësi i sektorit plotëson në sistem numrin e imazheve të porositura dhe parashikimin e ditëve që kërkon realizimi i porosisë, sipas të dhënave të siguruar nga evidencuesi dhe pas pagesës nga kërkuesi të faturës së gjeneruar automatikisht nga sistemi, printon urdhrin e skanimit, që firmoset nga Drejtori i Përgjithshëm. Pas skanimit, dokumentet i shërbehen kërkuesit brenda afatit të parashikuar në fillim të procedurës. Nëse pagesa nuk është kryer deri në pesë ditë pas gjenerimit të faturës, specialisti evidencues e kthen njësinë e ruajtjes në vendruajtje."
 - c. Pas fjalisë së dytë, të pikës 9, të nenit 6, shtohet kjo fjali:


“Nëse specialisti evidencues munjon të nesërmen e evidencimit, dokumentet e evidencuara prej tij kalojnë në shërbimin e skanimit nga përgjegjësi i sektorit, në praninë e evidencuesve të tjerë, duke mbajtur procesverbalin përkatës, të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit, mbi garantimin se kalimi është kryer pa ndërhyrë në njësitë e ruajtjes.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Evidencës Qendrore dhe Komunikimit për zbatimin e këtij urdhëri.
3. Ngarkohet Sektori i Sekretari-Arkivit për shpërndarjen e këtij urdhëri dhe konfirmimin e marrjes së tij nga të gjithë specialistët, punonjësit dhe përgjegjësit e përmendur në këtë urdhër.
4. Ngarkohet Sektori i Sallës së Studimit dhe Bibliotekës të njoftojë orarin e ri të sallës së studimit në mjedise të dukshme në hyrje të sallës, në brendi të saj si edhe në hyrje të institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi më 1 korrik 2019.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Dr. Ardit BIDO



Grupi i punës:

Arben Dervishi - kryetar

Endrit Musaj - anëtarë

Elsa Saka - anëtarë